



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Operatorit ekonomik “BNT Electronics” shpk

Adresa: Tirane Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive”.

Referenca e procedurës: REF-78510-11-12-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive”

Fondi limit: Fondi limit në total: 41,265,000 (dyzet e një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të VKB-së Nr. 157, datë 26.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020” (i ndryshuar)

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 07.12.2020

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 101 datë 16 Nëntor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë -

1. Operatori ekonomik BNT Electronics

NUIS J61817047D

Vlera e ofertës pa tvsh **40.381.600 (dyzet milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë.**

2. Operatori ekonomik Soft & Solution shpk

NUIS: L11328009F

Vlera e ofertës pa tvsh 41,242,331 (dyzet e një milion e dyqind e dyzetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë.

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomikë për arsyet si më poshtë vijon:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Soft & Solution shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

1.Operatori ekonomik "Soft & Solution" sh.p.k për plotësimin e "Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, nuk ka paraqitur deklaratë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura, sipas Shtojcës 8 të Dokumentave Standarde të Tenderit.

Shenim: a) Ka paraqitur kopjen elektronike nga QKB:

b)Vërtetimet elektronike nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik ka dorëzuar:

Data 11.11.2020 –vertetim per tatimet

Datac 15.10.2020- vertetim per kontributet

2.Operatori ekonomik "Soft & Solution" sh.p.k., nuk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë, të kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit, përkatësisht:

b.. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3.Autoriteti kontraktor, në pikën 2.2.3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ka kërkuar:

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së të gjitha detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të QKR-së, për vitin 2020 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB)

Operatori ekonomik "Soft & Solution" sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

4.Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, është kërkuar: 2.3.1 “Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit në një vlerë jo më e vogël se 40% e fondit limit të prokurimit ose 16.506.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtë mijë) lekë pa tvsh”.

- Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin:

- Kontratë me nr. 4155 prot., datë 23.08.2018 të nënshkruar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe BOE ”Soft&Solutions” sh.p.k. & ”BNT Electronics” sh.p.k., me objekt ”Përmirësimi i sistemit të aplikimit online për leje ndërtimi”.

Operatori ekonomik ”Soft&Solutions” sh.p.k., pjesë BOE, referuar marreveshjes së bashkëpunimit të paraqitur, ka marrë përsipër të realizojë vetëm shërbimet referuar kontratës së mësipërme, konkretisht komponentët softëare, trajnim dhe mirëmbajtje. Referuar sa më sipër, zërat që ka marrë përsipër të realizojë operatori ekonomik ”Soft&Solutions” sh.p.k nuk përmbushin kriterin e paraqitjes së kontratës së ngjashme të furnizimit me mallra.

- Kontratë nr.4966 prot., datë 16.08.2019, të nënshkruar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe ”Soft&Solutions” sh.p.k., me objekt ”Sistemi i lejeve të fluturimit”.

Referuar kontratës së sipërcituar, faturave tatimore të shitjes dhe zërave të përmendur në to, rezulton se furnizimet e ngjashme përmbushin një vlerë prej **2,534,881** (dy milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh (Furnizim + Vendosje) . Vlera e furnizimeve të ngjashme me procedurën objekt vlerësimi, nuk përmbush vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, përkatësisht **16.506.000** (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtë mijë) lekë.

Sa më sipër, OE nuk e ka përmbushur kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik, si pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit.

Në vijim të verifikimit të përmbushjes së kritereve të kualifikimit të përcaktuara si pjesë e kërkesave të kapacitetit teknik, komisioni i vlerësimit konstatoi se:

5.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion, për të vërtetuar përmbushjen e kriterit 2.3.2, sipas së cilit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për zërat 1-10, 14, 16 (referuar dokumentit të specifikimeve teknike) të ofertuara për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi”.

6. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion, për të vërtetuar përmbushjen e kriterit 2.3.6, sipas së cilit: “Operatori ekonomik duhet të zotërojë status partneriteti të paktën të nivelit Gold (ose ekuivalent) për pajisjet e prodhuesit referuar zërave të infrastrukturës (Hapësirë shtesë për storage ekzistues, Server, Server Toëer) të ofertuara. Për të provuar këtë kërkesë duhet të paraqitet certifikata apo deklarimi zyrtar në faqen ëb përkatëse”.

7. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion, për të vërtetuar përmbushjen e kriterit 2.3.7, sipas së cilit: “Operatori ekonomik duhet të deklarojë stafin teknik përgjegjës për mallrat dhe instalimin sipas specifikimeve teknike, për të garantuar suportin dhe garancinë e tyre përgjatë periudhës së parashikuar, si më poshtë”:

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për secilën nga pajisjet e mëposhtme të ofertuara:
 - a) Kompjuter Desktop
 - b) Kompjuter Ëorkstation 1
 - c) Kompjuter Ëorkstation 2
 - d) UPS
 - e) Server
 - f) Server Toëer
 - g) Scanner ADF
 - h) Printer & Skaner
 - i) Fotokopje BË 1
 - j) Fotokopje BË 2
 - k) Hapësirë shtesë për storage ekzistues

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për sëitching and routing në nivel min profesional për konfigurimet e nevojshme në rrjet.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar MCSA për Ëindoës Server ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel ekspert për Infrastrukturë nga Microsoft ose ekuivalent për të gjithë instalimet dhe konfigurimet e nevojshme të serverave.

Për të vërtetuar këtë kërkesë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë të Operatorit Ekonomik për stafin përgjegjës
- Certifikatën përkatëse
- Listepagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 6 muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

8. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion, për të vërtetuar një nga kriteret e rëndësishme, përmbushjen e kriterit 2.3.8, sipas së cilit: “Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë/brosurë për mallin që oferton. Fleta ose fletët e katalogut/brosurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara”. OE nuk ka paraqitur ofertë teknike për procedurën e prokurimit.

Në përfundim të sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k., **ka rezultuar se nuk ka përmbushur** kriteret e përcaktuara në dokumentat standarde të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe ripërtëritja e teknologjisë audiovizive” .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "BNT Electronics" shpk** me adresë: Tirane Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja16, Kati 2, Ap.1, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **40.381.600 (dyzet milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind)** lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 14.01.2021.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor,Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.